**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**Kryetari i Komunës**
**Nr.** 01-020/04-0006058-2/24 **dt.** 30.01.2024
**Mitrovicë**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0006058/24, dt. 26.01.2024, të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kryetari i Komunës sjell këtë:

# V E N D I M
**(Për Formimin e Komisionit për Hartimin e Rregullores së Brendshme Komunale për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare)**

1. **FORMOHET** Komisioni për Hartimin e Rregullores së Brendshme Komunale për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare, në këtë përbërje:

   **1.1** Hedije Mikullovci – kryetare (DBF);
   **1.2** Alketa Shaqiri Pireva – anëtare ( QKMF);
   **1.3** Gonxhe Prekazi – anëtare (DBF).

2. Komisioni është përgjegjës që të bëj hartimin e Draft Rregullores së Brendshme Komunale për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në bashkëpunim me konsulentin e USAID, duke bërë harmonizimin e saj, dhe duke përfshirë kërkesat dhe nevojat e drejtorive komunale në bazë të dispozitave ligjore pozitive në fuqi.

3 Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores së lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për Shqyrtim dhe miratim përmes Kryetarit të Komunës.

4 Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5 Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundim të detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.

6 Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA

**Shtojcë:**

1x1 Propozim-Vendimi i DBF-së Nr. 01-020/04-0006058/24, dt. 26.01.2024

**T'i dërgohet:**

**1x1** Kryetarit të Komunës
**1x1** Zyrës Ligjore
**1x1** Zyrës për Informim
**1x1** Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
**1x1** Anëtarëve të Komisionit
**1x1** Arkivit